



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
Nr. 62 datë 30.09.2024

“PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË SHKODËR”(2024-2029)

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 30.09.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin Nr 8419, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Nenet 23,33 dhe 54 shkronja “k” të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjin Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë,i ndryshuar, Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 8094 datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave, Nenet 12,13 të Ligjit Nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” , të ndryshuar, Ligjin Nr. 10431 datë 09.06.2011 “ Për mbrojtjen e mjedisit” të ndryshuar, Ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar, Ligjin 9010 datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, Ligjin Nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Ligjin Nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, VKM Nr.452 datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të Policisë Bashkiake”. VKM Nr.575 datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave, menaxhimin e mbetjeve inerte”, VKM Nr. 660 datë 31.10.2018 “ Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve të metaleve”, VKM Nr.608 datë 17.09.2014 “ Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si edhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”, VKM Nr.687 datë 29.07.2015 “ Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, të ndryshuar, VKM Nr.127 datë 11.02.2015 “Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura”, VKM Nr.418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, VKM Nr.117 datë 13.02.2013 “Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje”, të ndryshuar, VKM Nr.957 datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, VKM Nr.765, datë 07.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të pëtdorura”, VKM Nr.705 datë 10.10.2012 “Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës”,VKM Nr. 452 datë 11.07.2012 “Për landfill-et e mbetjeve”, të ndryshuar, VKM Nr.177 datë 06.03.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, të ndryshuar, VKM Nr.178 datë 06.03.2012 “Për

incinerimin e mbetjeve”, VKM Nr.319 datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, VKM Nr.418 datë 27.05.2020 “ Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035”, VKM Nr.447 datë 16.06.2010 “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, VKM Nr.652 datë 14.09.2016 “ Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve për gomat e përdorura, VKB Nr.35 datë 26.10.2023 “Për miratimin e rregullores për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane Bashkia Shkodër”, Urdhër Nr.994 datë 30.08.2023 “ Mbi miratimin dhe zbatimin e PSV për administrimin e ofrimit të shërbimit të pastrimit të Bashkisë Shkodër” dhe sipas relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të mbetjeve të Ngurta Urbane Bashkia Shkodër (2024-2029), sipas materialit bashkëngjitur, pjesë integrale e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 29 vota
Vota Pro 29
Vota Kundër 11
Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 01.10.2024

SEKRETARE

Sabina Danaj

KRYETAR

Oltion LULI

